

V E N D I M
Nr.140, datë 22.3.1995

PËR REGJISTRIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT

Në bazë të dekretit të Presidentit të Republikës “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit” dhe me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Për regjistrimin e përfituesve ligjorë të bonove të privatizimit

1. Regjistrimi i pjesës së popullsisë që, në bazë të dekretit të Presidentit të Republikës “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit”, përfiton bono privatizimi, të fillojë në datën 1.4.1995 dhe të përfundojë në datën 30.5.1995.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet drejtorive të sigurimeve shoqërore në të gjitha rrethet e vendit, të hartojë listat e pensionistëve, të inkuadruara përkatësisht në grup-moshën 35-55 vjeç dhe 55 vjeç e lart (datë referuese është 1.1.1995 dhe paraqitja e të dhënave të bëhet sipas udhëzimit të përmendur në pikën I/9 të këtij vendimi).

3. Institucionet buxhetore dhe ndërmarrjet ekonomike shtetërore, në bazë të listëpagesave të pagave, të hartojnë listat e të punësuarve pranë tyre sipas grup-moshave që përmenden në pikën 5 të këtij vendimi.

4. Këshillat e rretheve të hartojnë listat për ata persona me banim në fshat, të cilët nuk kanë qenë punësuar në kooperativa dhe ndërmarrje bujqësore (të dhëna të detajuara për përpilimin e listave do të jepen në udhëzimin e përmendur në pikën I/9 të këtij udhëzimi).

5. Ngarkohen zyrtarë e gjendjes civile pranë bashkive të hartojnë listat për atë pjesë të popullsisë që përfshihet në klasifikimin e grup-moshave vijuese:

- Shtetas të moshës 18-35 vjeç (të datëlindjes 1.1.1960-1.1.1977).
- Shtetas të moshës 36-55 vjeç (të datëlindjes 1.1.1940-31.12.1959)
- Shtetas të moshës 56 vjeç e lart (të datëlindjes përpara 31.12.1939).

6. Agjencia Kombëtare e Privatizimit të hartojë listat e personave që kanë përfituar nga procesi i privatizimit të njësive dhe ndërmarrjeve shtetërore pa ankand.

7. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të hartojë listën e personave që kanë përfituar nga procesi i privatizimit të ndërmarrjeve bujqësore.

8. Secila nga listat e mësipërme për të gjithë përfituesit e bonove të privatizimit duhet të pasqyrojë të dhëna personale dhe rezidenciale (sipas udhëzimit të përmendur në pikën I/9 të këtij vendimi).

Listat e përgatitura:

- Të paraqiten pranë Qendrës së Informacionit Financiar brenda datës 30.4.1995.
- Të ruhen në arkivin përkatës të subjekteve të sipërpermendura.
- Të dërgohen kopje të konfirmuara nga të gjitha subjektet në Qendrën e Informacionit Financiar.

9. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të hartojë një udhëzim të detajuar për realizimin e procesit të regjistrimit, përqendrimit dhe kontrollit të listave të hartuara në mbarë vendin, deri në momentin e dorëzimit të tyre në Bankën e Kursimit.

II. Për shpërndarjen e bonove të privatizimit:

1. Banka e Kursimeve të fillojë shpërndarjen e bonove të privatizimit nga data 20 prill dhe të përfundojë brenda datës 15 qershor 1995. Listat e përfituesve të bonove të privatizimit të shpërndahen në degët e Bankës së Kursimeve në rrethe mbi bazë vendbanimi.

2. Banka e Kursimeve të përgatitë sportelet për shpërndarjen normale dhe në kohë të bonove të privatizimit në të gjitha degët e saj.

3. Banka e Kursimeve merr në dorëzim:

a) bonot e privatizimit nga Banka e Shqipërisë dhe përgjigjet për ruajtjen dhe transportin e sigurt, numrin e saktë të bonove që do të shpërndahen nëpër degët e bankave, në përputhje me listat përkatëse;

b) listat e përfituesve të bonove të privatizimit nga Qendra e Informacionit Financiar.

4. Në degët e Bankës së Kursimit:

Qytetari:

- paraqet dokumentin e indentifikimit (pasaportë ose çertifikatë personale të vulosur në zyrën e gjendjes civile dhe të pajisur me fotografi);
- paguan në këmbim të çdo bono privatizimi një komision, në vlerë të barabartë për të gjithë përfituesit, 50 lekë.

Nëpunësi i bankës:

- për çdo bono që shpërndan, shënon në listën e regjistrimit detajet e dokumentit të indentifikimit;
- vulos me një vulë tepër cilësore çdo bono privatizimi; bonot do të konsiderohen të pavlefshme në rast se nuk përmbajnë vulën e Bankë së Kursimeve.

Banka e Kursimeve duhet të ndjekë dhe evidencojë përputhjen e plotë në çdo degë banke mes gjendjes fizike të bonove dhe numrit të bonove të shpërndara (të dhëna), dokumentet dhe listat e përfituesve të asaj dite dhe të administrojë komisionet e mbledhura.

5. Për personat që nuk kanë mundësi të paraqiten vetë për të marrë bonot e privatizimit, si të burgosurit, ushtarët, të sëmurët në spitalet psikiatrike, ata që jetojnë jashtë, të sëmurët dhe ata që janë të pamundur të dalin nga shtëpitë, të veprohet vetëm me peronat e autorizuar noterialisht prej tyre, ose kujdestarët e tyre të njohur me ligj.

6. Shpërndarja e bonove të privatizimit të përfundojë në datën 30.7.1995.

III. Kontrolli dhe përpunimi

Qendra e Informacionit Financiar të kryejë përpunimin dhe kontrollin e të dhënave dhe t'i raportojë në vijimësi Ministrisë së Financave për ecurinë e privatizimit masiv.

1. Qendra e Informacionit Financiar të realizojë:

- Kontrollin e përfituesve të bonove të privatizimit për mënjanimin e përfitimeve të jashtëligjshme etj.
- Rakordimin e numrit total të bonove të privatizimit të shtypura.

2. Një komision i veçantë, me përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Banka e Kursimeve, Drejtoria e Privatizimit në Ministrinë e Financave, Qendra e Informacionit Financiar dhe Sekretariati i Pushtetit Lokal, ka të drejtë të vendosë në rastet e reklamimeve dhe denoncimeve në bazë të kriterëve të dekretit të Presidentit të Republikës, brenda 10 ditëve, për dhënien e bonove të privatizimit personave të interesuar, ose tërheqjen e tyre nëse ato nuk janë shpërndarë në përputhje me dekretin e Presidentit të Republikës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi